



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TRANSPORTIT  
DHE INFRASTRUKTURËS  
Nr.6311 datë 29 /12 / 2016

UNIVERSITETI POLITEKNIK  
I TIRANËS  
Nr.1565 datë 29 /12 / 2016

## MARRËVESHJE

NDËRMJET

MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

DHE

UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

PËR

BASHKËPUNIMIN E FAKULTETIT TË INXHINIERISË SË NDËRTIMIT  
DHE INSTITUTIT TË TRANSPORTIT

**Me qëllim** realizimin e funksionimit të kursit për auditues/inspektues të sigurisë rrugore;

**Nëpërmjet** programeve mësimore në fushën e sigurisë rrugore;

**Të sigurt** se bashkëpunimi ndërinstitucional është vendimtar në arritjen e objektivave të përbashkëta, për të trajnuar dhe çertifikuar audituesit/inspektuesit e sigurisë rrugore;

Bazuar në:

- Ligjin nr.8378, datë 22.07.21998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë“, i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.125, datë 23.02.2011, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore 2011 – 2020”;

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 23.11.2011 “Për një ndryshim në VKM nr.153, datë 07.04.2000, “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Udhëzimin nr. 9, datë 3.07.2012 “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore”;
- Direktivën 2008/96/CE e Parlamentit dhe e Këshillit European e datës 19 Nëntor 2008, “Mbi menaxhimin e sigurisë në infrastrukturën rrugore”

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI) dhe Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT), në vijim palët, për të siguruar bashkëpunimin ndërmjet strukturave të tyre, përkatësisht Instituti i Transportit (IT) dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN), kanë rënë dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje:

## Neni 1

### *Objekti dhe Qëllimi*

Objekti dhe qëllimi i kësaj Marrëveshje është forcimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarisë së strukturave të dy institucioneve për marrjen e masave për të realizuar funksionimin e kursit të trajnimit për auditues/inspektues të sigurisë rrugore, në mbështetje të objektivave të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore, sipas direktivave dhe udhëzimeve të BE.

## Neni 2

### *Autoritetet kompetente*

Autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

- për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore dhe Instituti i Transportit;
- për Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.

## Neni 3

### *Detyrimet e Institutit të Transportit*

1. Instituti i Transportit ka për detyrë të verë në dispozicion ambientet me të gjithë infrastrukturën e nevojshme didaktike, për funksionimin e kurseve.
2. Instituti i Transportit është përgjegjës për ngritjen dhe funksionimin e këtij kursi. Ai ka për detyrë ngritjen e strukturave të nevojshme për mbarëvajtjen e këtij kursi dhe përgjigjet për menaxhimin teknik dhe financiar të tij.

3. Instituti i Transportit ngre një komision për përzgjedhjen e personave që kanë aplikuar për kryerjen e kursit të auditimit/inspektimit të sigurisë rrugore, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, në mbështetje të nenit 5 të kësaj marrëveshje.
4. Komisioni nëpërmjet faqes zyrtare të IT, njofton se çfarë dokumentash do të paraqiten nga kursantet dhe shpall datën e fillimit dhe të mbarimit të aplikimit për auditues/inspektues të sigurisë rrugore.
5. Dokumentacioni i aplikimit nga personat e interesuar, paraqitet pranë sekretarisë së IT-së.
6. Pas 3 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, komisioni merr nga sekretaria dokumentacionin e aplikimit për të filluar shqyrtimin dhe pas 7 ditëve nga dita e mbylljes së aplikimeve shpall fituesit.

#### Neni 4

#### *Detyrimet e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit*

1. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit ka për detyrë të verë në dispozicion emrat e pedagogëve që do të jenë trajnues në këtë kurs.
2. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit duhet të miratojë programet mësimore të hartuara nga IT, për funksionimin normal të këtij kursi.
3. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit ka për detyrë të verë në dispozicion emrat e personave që do jenë anëtarë në Bordin Drejtues, anëtarë të komisionit të përzgjedhjes së kandidatëve, anëtarë të komisionit të vlerësimit të performancës (provimit)

#### Neni 5

#### *Kërkesat për Auditues/Inspektues të sigurisë rrugore*

Në mbështetje të nenit 10 të Udhëzimit të përbashket të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Brendshme Nr. 9, datë 03.07.2012, kërkesat e specifikuar për ndjekjen e kursit do të jenë si më poshtë:

Çdo person i cili dëshiron të bëhet auditues/inspektues i sigurisë rrugore, duhet të plotësojë këto kërkesa:

##### 1. Inxhinjeri mekanike

- a) diplomë universitare në fushën e inxhinierisë mekanike 4 ose 5 vjecare, para 2007 me të paktën një nga kushtet e mëposhtëme:
  - të jetë aktivizuar në mësim dhënie në fushën e sigurisë rrugore,
  - të jetë marrë me probleme të sigurisë rrugore në administratë,

- të jetë marrë me analiza dhe ekspertizë aksidentesh për një periudhë të paktën 5 vjeçare,
  - të ketë botuar artikuj ose libra në lidhje me fushën e sigurisë rrugore.
  - përvojë në projekte të Sigurisë Rrugore.
  - të ketë mbaruar Master Profesional (MP) në fushën e Transportit.
- b) diplomë në inxhinieri mekanike bachelor ose MSH pas 2007 (por duhet të ketë mbaruar edhe kursin Master Profesional (MP) në fushën e Transportit.
- c) diplomë në inxhinieri mekanike Master Profesional (MP) profili mjete lëvizëse (ose fushë transporti).

ose,

## 2. Inxhinjeri ndërtimi.

- a) diplomë universitare në fushën e inxhinierisë së ndërtimit 4 ose 5 vjeçare para 2007 me të paktën një nga kushtet e mëposhtëme:
- të jetë aktivizuar në mësim dhënie në fushën e sigurisë rrugore,
  - të jetë marrë me probleme të sigurisë rrugore në administratë,
  - të jetë marrë me analiza dhe ekspertizë aksidentesh për një periudhë të paktën 5 vjeçare,
  - përvojë profesionale në fushën e projektimit të rrugëve, ose në fushën e sigurisë rrugore.
  - të ketë botuar artikuj ose libra në lidhje me fushën e sigurisë rrugore.
  - të ketë mbaruar Master Profesional (MP) në fushën e Transportit.
- b) diplomë në inxhinieri ndërtimi profili Infrastrukturë Transporti,
- c) diplomë në inxhinieri ndërtimi bachelor dhe Master Profesional (MP) në fushën e Transportit.

ose,

## 3. Diplomë universitare në fushën e inxhinierisë elektrike me të paktën një nga kushtet sikurse kërkohet në pikën 1 ose 2.

dhe

## 4. Pjesëmarrje në kurse trajnimi për auditues dhe paisja me një certifikatë si auditues / inspektues, sipas kushteve të parashikuara në këtë udhëzim (neni 11);

## 5. Aftësi fizike për të ushtruar detyrën;

## 6. Nuk ka kufizim ligjor për ushtrimin e aktivitetit.

## Neni 6

### *Forma e organizimit të kursit të trajnimit*

1. Kursi i trainimit për auditues/inspektues të sigurisë rrugore, organizohet në mbështetje të VKM-së nr. 815 datë 23.11.2011 dhe nenit 11 e 12 të Udhëzimit nr. 9 datë 03.07.2012 “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore”
2. Kursi do të organizohet pranë ambjenteve të Institutit të Transportit dhe do të funksionojë në bazë të një programi trajnimi të mbështetur në nenin 11 të Udhëzimit nr. 9, datë 03.07.2012.
3. Instituti i Transportit do të jetë përgjegjës për funksionimin e këtij kursi.
4. Organizimi dhe funksionimi i kursit të trainimit për auditues/inspektues do të bëhet nëpërmjet;
  - a. Bordi Drejtues.
  - b. Komisioni i përzgjedhjes së kandidatëve.
  - c. Komisioni i vlerësimit të performancës (provimit).

## Neni 7

### *Bordi drejtues*

1. Të gjitha vendim-marrjet për funksionimin e kursit të trainimit për auditues/inspektues të Sigurisë Rrugore do të bëhen nga Bordi Drejtues.
2. Bordi drejtues përbëhet nga:

Drejtori i Përgjithshëm i Standarteve dhe Monitorimit në MTI	kryetar
Drejtori i IT	anëtar
Dekani i FIN	anëtar

## Neni 8

### *Komisioni i përzgjedhjes së kandidatëve*

1. Për përzgjedhjen e kandidatëve që kanë aplikuar për kryerjen e kursit ngrihet Komisioni i përzgjedhjes së kandidatëve, konform pikës 3 të nenit 3 të kësaj Akt marrëveshje dhe miratohet me vendim të Bordit Drejtues.

Ky komision përbëhet nga:

një përfaqësues nga MTI	kryetar
një përfaqësues nga IT	anëtar
një përfaqësues nga FIN	anëtar
një përfaqësues nga ARRS	anëtar

2. Çdo institucion i përfshirë në këtë komision cakton përfaqësuesin e tij, i cili për rastin e IT, ARRSH dhe FIN duhet të jetë trainues, ndërsa për MTI duhet të jetë specialist i DQSRr. Rekomandohet që përfaqësuesit e komisionit të jenë me titull shkencor, ndërsa për institucionet që nuk kanë persona me grada shkencore të përfaqësohen me specialistë të fushës së sigurisë rrugore.

#### Neni 9

##### *Detyrat kryesore të komisionit të përzgjedhjes së kandidatëve*

1. Pas përfundimit të afatit të aplikimit, brenda 3 ditëve (ditë pune zyrtare) Komisioni grumbullon dokumentacionin e aplikimit në sekretarinë e Institutit të Transportit, dhe fillon shqyrtimin e tyre. Vlerësimi bëhet sipas kërkesave të nenit 5 të kësaj marrëveshje.
2. Pas 7 ditëve nga dita e mbylljes së aplikimeve Komisioni shpall fituesit.
3. Në rast se numri i personave që kanë fituar është më i vogël se 10, por minimumi 5, kursi zhvillohet.
4. Në rast se në bazë të kërkesave nga të interesuarit plotësojnë kushtet më shumë se 10 vetë, komisioni do të bëjë një përzgjedhje mbi bazën e kriterëve teknike më të favorshëm, të cilët janë më afër fushës së inxhinierisë së ndërtimit dhe inxhinierisë mekanike dhe sa më afër qëllimit të kursit. Kandidatët që plotësojnë kushtet por janë renditur mbi numrin 10, do të zhvillojnë trajnimin në kursin pasardhës.

#### Neni 10

##### *Komisioni i vlerësimit të performancës (provimit)*

Me përfundimin e programit të trajnimit, kursantët i nënshtrohen provimit përpara komisionit të vlerësimit.

Komisioni i vlerësimit përbëhet nga:

një përfaqësues nga MTI	kryetar
një përfaqësues nga IT	anëtar
një përfaqësues nga FIN	anëtar
një përfaqësues nga ARSH	anëtar

Përfaqësuesit e këtij komisioni duhet të jenë nga stafi trajnues.

#### Neni 11

##### *Trajnimi*

1. Kursi i trajnimit do të zhvillohet dy herë në vit (nga një kurs çdo gjashtë muaj). Numri i kursantëve për çdo grup do të jetë maksimumi 10.



2. Me vendim të Bordit drejtues, nqs ka kërkesa të shtuara, mund të zhvillohen më shumë se dy kurse në vit.

3. Çdo person i caktuar me cilësinë e trajnuesit për auditues/inspektues duhet të plotësojë kushtet e pikës 2 të nenit 12 të Udhëzimit Nr. 9, datë 03.07.2012.

#### Neni 12

##### *Programi i trajnimit*

1. Çdo person i zgjedhur nga komisioni i përzgjedhjes së kandidatëve, në bazë të dokumentacionit që plotëson kushtet e nenit 5 të kësaj marëveshje, do t'i nënshtrohet kursit. Pas përfundimit të periudhës së programit të kursit, personi duhet të kalojë me sukses një provim për të marrë certifikatën e aftësisë si auditues/inspektues i sigurisë rrugore.

2. Kohëzgjatja e kursit për auditues/inspektues, mbështetur në Udhëzimin Nr. 9 datë 03.07.2012 do të jetë 9 ditë.

3. Kursi do të zhvillohet dy herë në javë, respektivisht ditën e premte ora 16.00-19.00 dhe ditën e shtunë ora 10.00-14.00

4. Ora e mësimit do bëhet nga 45 min dhe 15 min pushim.

5. Programi mësimor dhe temat ditore sipas moduleve, caktohen nga IT dhe i jepen kursantëve ditën parë.

#### Neni 13

##### *Programi mësimor*

Shpërndarja e ditëve për relizimin e programit mësimor bëhet nga IT.

1. Programet e trajnimit do të kenë këtë përmbajtje:

➤ Teoria.

- a. njohuri përkatëse të sigurisë rrugore në standartet dhe rregullat teknike të projektimit të rrugëve;
- b. materiale që kanë të bëjnë me procesin e auditimit të vëndeve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, që kanë eksperiencë në fushën e auditimit të sigurisë rrugore;
- c. udhëzuesi i auditimit dhe inspektimit të sigurisë rrugore.

➤ Praktika.

- a. shembuj ushtrimor dhe pjesë projektesh që kanë të bëjnë me auditimin/ inspektimin;

- b. studime mbi auditime të mëparshme të projekteve tipike të rrugëve (segmente autostrade, rrugë interurbane, rrugë urbane, rrugë lokale, kryqëzime, etj)

## 2. Kalendari i zhvillimit të programit:

FAZAT	EMERTIMI	KOHA
I	a. Pjesa teorike. b. Raste studimore (auditim/inspektim i rrugëve sipas klasifikimit)	3 ditë
II	a. Pjesa teorike. b. Eksperienca auditimi të ndryshme nga vënde dhe organizma të tjera ndërkombëtare.	3 ditë
III	Pjesa praktike. Shëmbull studimor i një projekti kompleks (vlerë e madhe dhe tipologji të ndryshme rrugësh)	2 ditë
IV	Mbyllja e seminarit dhe pajisja me certifikatë	1 ditë

### Neni 14

#### *Modulet e kursit*

Në bazë të Udhëzuesit për Auditimin/Inspektimin e Sigurisë Rrugore dhe nenit 11 të Udhëzimit Nr. 9, datë 03.07.2012, kursi do të ketë 9 module mësimore si më poshtë;

#### Tabela e Moduleve të Kursit.

MODULI	Përshkrimi i temave të modulit.	Orë mësimore
Moduli 1	Konceptet bazë të sigurisë Rrugore. Faktorët dhe shkaktarët e aksidenteve.	7
Moduli 2	Analiza e aksidenteve. Prezantimi i raporteve vjetore. Strategjia e Sigurisë Rrugore dokumenti bazë për vizionin 0 aksident.	7
Moduli 3	Metodologjia e parashikimit të performancës së Sigurisë rrugore në rrugët urbane dhe interurbane. Koeficientët korigjues. Parametrat vlerësues të aksidenteve dhe analiza e tyre.	7
Moduli 4	Black Spotet, çfarë janë si vlerësohen, normat dhe kriteret bazë. Shembuj të rrjetit rrugor në vendin tonë. Analiza dhe vlerësime të tyre. Raste praktikash më të mira.	7



<b>Moduli 5</b>	Auditimi i Sigurisë Rrugore dhe Inspektimi, çfarë janë, pse duhen, dhe metodologjia e realizimit të një Auditimi / Inspektimi. Hapat kryesore të një Auditimi/Inspektimi. Raste praktike.	7
<b>Moduli 6</b>	Ndikimi i trafikut në aksidentet rrugore, si vlerësohet dhe cilat janë parametrat vlerësues të trafikut.	7
<b>Moduli 7</b>	Marrëdhënia e aksidenteve me infrastrukturën rrugore. Dizajni i rrugës (Planimetria leximi i saj). Parametrat gjeometrike të projektimit të rrugëve, rëndësia dhe roli i tyre në aksidentet rrugore.	7
<b>Moduli 8</b>	Njohuri bazë mbi sistemin GIS aplikimi dhe rëndësia e përdorimit të tij në analizën e aksidenteve rrugore. Hedhja e të dhënave.	7
<b>Moduli 9</b>	Sinjalitika rrugore, roli dhe rëndësia e saj në parandalimin e aksidenteve. Planifikimi i sinjalitikës që në momentin e planifikimit dhe dizajnit të rrugës, elementet bazë.	7

#### Neni 15

##### *Provimi*

Pas dy javësh nga përfundimi i kursit bëhet provimi me shkrim dhe me gojë përpara komisionit të vlerësimit.

Kursantëve që fitojnë testimin ju jepet certifikata. Kursantët që nuk fitojnë testimin, bëjnë vetëm riprovim sipas vendimit të Bordit drejtues dhe, nuk kryejnë pagesë tjetër.

#### Neni 16

Pranë Institutit të Transportit hapet një regjistër i regjistrimit të kursantëve pas përfundimit të kursit.

Lista me fituesit e kursit i dërgohet Njesisë së auditimit/inspektimit të sigurisë rrugore, pranë MTI-së, ARSH-së dhe Bashkive, të caktuara me Udhëzimin nr.9, datë 3.07.2012, “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore”

#### Neni 17

##### *Çertifikata*

Pas përfundimit me sukses të testimit Audituesi/Inspektuesi i sigurisë rrugore pajiset me një certifikatë tip 1 sipas modelit të miratuar (bashkëlidhur)

Rregjistrimi i Audituesve/Inspektuesve bëhet në “Rregjistrin e Audituesve / Inspektuesve të Sigurisë Rrugore” pranë IT-së.

## Neni 18

Stafi Trajnues në këtë kurs trajnimi fiton direkt Certifikatën për Auditues / Inspektues të Sigurisë Rrugore pa pagesë.

## Neni 19

### *Financimi dhe Mjetet Kryesore*

Veprimtaria teknike, administrative dhe financiare e kursit do të kryhet nga Instituti i Transportit në bazë të kësaj Marrëveshje.

Pagesat e organeve të percaktuara në nenin 6 të kësaj Akt marrëveshje, kryhen nga IT, në zbatim të VKM-se nr. 432 datë 28.06.2006 dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave përkatësisht, Nr. 12111 prot. dhe Nr. 8978 prot. datë 27.11.2006.

## Neni 20

Instituti i Transportit ve në dispozicion të kursit të gjithë asetet si zyrë, sallë, kompjuter, rrjetin telefonik, wi-fi dhe mjete të tjera logjistike për realizimin me sukses të kursit.

## Neni 21

Kursi për Auditues/Inspektues të sigurisë rrugore, do të bëhet kundrejt një pagese siç përcaktohet në pikën 4, neni 11, i Udhëzimit nr.9, datë 3.07.2012, "Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore".

## Neni 22

Pagesa për koston e kursit bëhet në llogarinë bankare të Institutit të Transportit. Certifikata jepet pasi të bëhet pagesa në bankë në llogarinë e Institutit të Transportit.

## Neni 23

Financimi i shpenzimeve të kryera për realizimin e kurseve të trajnimit të audituesve/inspektuesve të sigurisë rrugore do të bëhet nga të ardhurat dytësore të krijuara nga ky shërbim.

Përdorimi i të ardhurave të krijuara do të bëhet në përputhje me VKM nr. 432 datë 28.06.2006 dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave përkatësisht, Nr. 12111 dhe Nr. 8978 datë 27.11.2006.

Neni 24

*Pikat e kontaktit*

Për komunikimin në bazë të kësaj Marrëveshjeje, personat e kontaktit janë:

- për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtori e Institutit të Transportit;
- për Universitetin Politeknik të Tiranës, Dekani i Fakultetit të Inxhinjerisë së Ndërtimit;

Neni 25

*Dispozita të fundit*

1. Secila palë merr përsipër njohjen e strukturave të varësisë së tyre me detyrimet që rrjedhin prej kësaj Marrëveshjeje, si dhe respektimin e zbatimit të tyre.
2. Për çdo rast të mosplotësimit të detyrimeve të mësipërme, secila palë informon strukturat qendrore të autoriteteve përkatëse.
3. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet për një afat të pacaktuar. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e saj, palët mund të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse.
4. Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast se nuk arrihet zgjidhja në këtë mënyrë, Marrëveshja konsiderohet e përfunduar dhe e zgjidhur për të gjitha efektet, pasi njëra nga palët ka njoftuar me shkrim 30 ditë para përfundimit, palën tjetër.
5. Kjo Marrëveshje përpilohet në 4 (katër) kopje dhe secila palë mban nga dy kopje me vlerë të njëjtë.

MINISTRIA E TRANSPORTIT  
DHE INFRASTRUKTURËS

**BAHRI SHAQIRI**

ZËVENDËSMINISTËR

UNIVERSITETI POLITEKNIK  
I TIRANËS

**Prof. Dr. ANDREA MALIQARI**

REKTOR

**LISTA E PERSONAVE TË ÇERTIFIKUAR  
AUDITUES/INSPEKTUES TË SIGURISË RRUGORE.**

<b>Nr.</b>	<b>Emër Mbiemër.</b>	<b>Nr. Regjistrimit Themelor</b>
1.	Kumbim Shala	IT17K011
2.	Kreshnik Zgjani	IT17K012
3.	Korab Shehu	IT17K013
4.	Mikel Caku	IT17K014
5.	Fatmir Hasho	IT17K015
6.	Artur Sulce	IT17K016
7.	Leke Gjoni	IT17K017
8.	Albert Murati	IT17K018
9.	Ardian Asa	IT17K019
10.	Edison Drishti	IT17K020
11.	Mitat Tole	IT17K021
12.	Mamir Hodo	IT17K022
13.	Nimet Gjeta	IT17K023
14.	Evald Jaho	IT17K024
15.	Lorenc Tandili	IT17K025
16.	Flamur Mullisi	IT17K001
17.	Nikolin Berxhiku	IT17K002
18.	Gezim Hasko	IT17K003
19.	Arian Lako	IT17K004
20.	Ervin Paci	IT17K005
21.	Shkelqim Gjevori	IT17K006
22.	Meri Lumi	IT17K008
23.	Ariana Hasani	IT17K007
24.	Spartak Tarka	IT17K009
25.	Dorian Stafa	IT17K010